

RAPORTI VJETOR

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS

RAPORTI VJETOR 2022

RAPORTIMI I AKTIVITETEVE TË
ZHVILLUARA DHE PASQYRËS FINANCIARE





DHJETOR 2022

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE.....	5
ARRITJET E VITIT 2022:.....	6
I. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS	7
1.1 7	
1.2. ORGANET DREJTUESE.....	7
1.3. KËSHILLI DREJTUES.....	7
1.4 DREJTORI EKZEKUTIV.....	8
1.5 STRUKTURA ADMINISTRATIVE.....	8
1.5.1 DREJTORIA E DIASPORËS	9
1.5.2. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE.....	9
1.5.3. NJËSIA E MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE	9
II. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE	10
2.1. STRATEGJIA KOMBËTARE E DIASPORËS 2021-2025	10
2.2. GRUPI I KOORDINATORËVE	10
2.3. KËSHILLI KORDINUES I DIASPORËS	11
III. SAMITI I TRETË I DIASPORËS.....	12
IV. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS	13
4.1 TAKIME ME PROFESIONISTË NË DIASPORË.....	14
4.2 AKTIVITETE ME KOMUNITETE SHQIPTARE NË BOTË	15
4.4 AKTIVITETE TË TJERA	19
4.4.1 TAKIMI NË DATË 21 QERSHOR 2022, NË AMBIENTET E PREFEKTURËS KORÇË. BASHKËPUNIMI ME PREFEKTURAT PËRKATËSE PËR TË FUQIZUAR KOMUNIKIMIN MES AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE NJVV-VE.	19
4.4.2 AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS BËHET PJESË E KONFERENCËS KOMBËTARE TË NIVELIT TË LARTË ME TEMË "VOTIMET NGA JASHTË, KOHA ËSHTË TANI!"	20
4.4.3 AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS PJESË E SAMITIT TË GRUAS NË BIZNES.....	21
V. DATABAZA E STUDENTËVE.....	22
VI. SEKTORI I PROJEKTEVE	22
Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:	22
6.1 PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR ZBATIM	22
6.1.3 FUQIZIMI I GRAVE NË DIASPORË	23



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

VII. KOORDINIM ME DONATORËT E PROJEKTEVE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE DHE VEPRIMTARISË SË AKD-SË	23
7.1.1.	23
VIII. MARRËVESHJE DHE MEMORANDUME	25
IX. PUBLIKIME	26
9.1. BULETINI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT	26
9.2. REVISTA INFORMATIVE PËR BURSAT PËR DIASPORËN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	26
9.3. NEWSLETTER PËR DIASPORËN	26
X. MANUAL PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË STUDENTËVE	27
XI. RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHETËSE	27
28	
XII. PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE PËR 2023	33
PROGRAMI VJETOR I AKD-SË PËR VITIN 2023	33
PROGRAMI VJETOR PËR KOMUNITETET SHQIPTARE NË MBRETËRI E BASHKUAR, SH.B.A, GJERMANI, BRUKSEL, KROACI, ITALI, GREQI, TURQI, BULLGARI, TURQI ETJ.	34
AKTIVITETI VJETOR ME RASTIN E DITËS SË DIASPORËS.	34
TAKIME ME PROFESIONISTË NË DIASPORË (RRJETËZIMI)	34
TAKIMI I MJEKËSISË NË DIASPORË.	34
TAKIMI I JURISTËVE NË DIASPORË.	35
PROGRAMI VJETOR PËR ORGANIZIMIN E SHKOLLËS VERORE "JAM SHQIPTAR"	35
SFIDA NË TË ARDHMEN	35
PËRMBYLLJE	37





HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës është ndër institucionet kryesore shtetërore përgjegjëse për zbatimin e politikës së qeverisë shqiptare në marrëdhëniet e diasporës shqiptare me vendin e origjinës. Ajo ka për mision nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me komunitetet shqiptare në diasporë, me qëllim zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në zhvillimin ekonomik, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë.

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Diasporës përgatit raportin periodik vjetor mbi aktivitetet e realizuara.

Raporti Vjetor 2022 është një përmbledhje e funksioneve dhe aktiviteteve të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, kundrejt objektivave kryesore vjetorë dhe atyre strategjikë. Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2022 ka vepruar në përputhje me drejtimin strategjik dhe në një frymë me politikat qeveritare në fushën e diasporës.

Raporti shërben për të informuar institucionet përgjegjëse dhe publikun rreth veprimtarisë të Agjencisë gjatë vitit 2022. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës; struktura e institucionit, veprimtaria e institucionit gjatë vitit 2022, aktivitetet institucionale, aktet ligjore bazë për veprimtarinë e AKD si dhe analiza financiare për vitin 2022.

ARRITJET E VITIT 2022:

Në kuadër të aktivitet të saj për vitin 2022, AKD ka vazhduar me implementimin e “Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2022-2025”, ku për vitin 2022 ishin parashikuar 24 masa gjithsej, nga të cilat 20 masa kanë marrë përgjigje ndërsa 4 kanë mungesë informacioni. Shkalla e realizimit të zbatimit të strategjisë e shprehur në përqindje është 83.3%).

Gjatë vitit 2022 në vijim të forcimit të marrëdhënieve midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe organizatave jofitimprurëse të cilat veprojnë në diasporë, janë





nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me Shoqërinë e Akademikëve Shqiptarë – DIJA E.V, Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare si dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi.

Gjithashtu është vijuar me përditësimin e bazës së të dhënave për rrjetin e profesionistëve dhe bizneseve të suksesshëm në diasporë, “rrjetëzimin” midis ekspertëve, profesionistëve të ndryshëm nga diaspora.

“Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 – 2025” është në vitin e dytë të implementimit të saj. Agjencia Kombëtare e Diasporës, bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, i ndryshuar përgatit dhe koordinon punën për hartimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe ndjek zbatimin e saj.

Strategjia përcakton parimet e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e komuniteteve shqiptare të cilët jetojnë në vendet pritëse në mënyrë të ligjshme.

Referuar të dhënave të publikuara nga INSTAT, “Diaspora në shifra” në vitin 2020, sipas vlerësimeve të tërthorta, numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1,68 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 37 % të shtetasve shqiptarë gjithsej.

(<http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2020/diaspora-n%C3%AB-shifra-2020/>)

Diaspora e vjetër ka qenë e vendosur kryesisht në SHBA dhe disa vende të Evropës Perëndimore, ndërsa **Diaspora e re** është vendosur në Greqi, Itali, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Zvicër, Francë etj.

Bazuar në të dhëna të tjera si peoplemove.in rezulton se komuniteti më i madh shqiptar ndodhet në Greqi (<https://online.pubhtml5.com/fiit/chlo/#pw19>)

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 30, datë 17.2.2021 “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”, koordinatorët e referuar nga institucionet përgjegjëse raportojnë periodikisht dhe mbajnë një raport të ngushtë komunikimi dhe bashkëveprimi me Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

Është forcuar bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe shoqatave përfaqësuese të target grupeve të ndryshme të diasporës shqiptare, brenda dhe jashtë





vendit. Vlerësimi i organizatave shqiptare të diasporës dhe politikave të migrimit tregojnë për rolin në rritje që mund të luajë diaspora si ndërmjetësuese mes vendeve pritëse dhe vendit të origjinës. Organizatat e diasporës shqiptare në Perëndim, po përqendrohen edhe më shumë në mënyrën e organizimit më të mirë të tyre në vendet pritëse dhe përparësitë e tyre të brendshme. Ato po adresojnë situatën e anëtarëve të diasporës, të nevojave dhe kërkesave të tyre të ndërlidhura me pjesëmarrjen politike dhe të drejtat e punëtorëve, shtetësinë dhe të drejtat e komuniteteve fetare.

Për të patur rezultate konkrete: Agjencia Kombëtare e Diasporës, ka punuar ngushtësisht me diasporën shqiptare kudo në botë, si dhe me shoqata e organizata përfaqësuese të interesave të tyre, për promovimin e vlerave kombëtare, identitetit dhe trashëgimisë kulturore, por dhe në promovimin e diversitetit kulturor të diasporës tonë të cilët janë mbartës të kulturës jo vetëm të vendit të origjinës por dhe të vendit pritës, promovimin e pjesëtarëve të diasporës.

Shoqatat dhe organizatat shqiptare në shtete pritëse luajnë një rol të rëndësishëm në mekanizmat mbrojtës të të drejtave dhe përfaqësimit të interesave legjitim të anëtarëve të tyre.

Gjithashtu, ato luajnë një rol në adresimin e arritjeve dhe problematikave në komunitetet shqiptare si: të drejtat e arsimit dhe gjuhës (mësimi i gjuhës shqipe në vendet pritëse), të drejta politike si ushtrimi i të drejtës së votës së emigrantëve jashtë vendit etj.

Bashkëpunimi i ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore, ka qenë në fokus të aktiviteteve të këtij viti.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenin 29/1 të ligjit, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 456 datë.10.06.2020 “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetqeverisjen vendore”, përcaktohen qartë funksionet e Bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit, duke i bërë strukturat përkatëse në nivel vendor, përgjegjëse për kryerjen e funksioneve si vijon:

a) krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë së vetëqeverisjes vendore;



- b) nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;
- c) dhënien e ndihmës e të informacionit për çështje që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare;
- ç) dhënien e ndihmës e të informacionit për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni, për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve;
- d) koordinimin e bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e të informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.

Bashkëveprim të ngushtë ka pasur me Bashkinë Tiranë dhe Prefekturën Korçë, në kuadër të ri-integrimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të migrantëve duke respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e tyre njerëzore dhe në të njëjtën kohë të krijohen kushte të favorshme që i mundëson diasporës përmes kapaciteteve të tyre njerëzore, ekonomike dhe sociale të pasurojë shoqërinë tonë. Ky bashkëpunim do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal, pasi të gjitha Bashkitë, kanë miratuar planin vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën dhe funksionimin e strukturave përkatëse. Për këtë qëllim janë zhvilluar me Bashkinë Tiranë takim në datë 21 shtator 2022, si në Prefekturën Korçë takim në datë 21 qershor 2022, për dialogim dhe bashkëveprim për këtë qëllim.

I. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

1.1 AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS ËSHTË PERSON JURIDIK PUBLIK, ME STATUSIN E "AGJENCISË AUTONOME", ME SELI NË TIRANË. AGJENCIA FUNKSIONON NË BAZË TË LIGJIT NR. 115/2017 "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS" I NDRYSHUAR.

1.2. ORGANET DREJTUESE

Në përputhje me pikën 3 të nenit 5 të Ligjit Nr. 115/2017 "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën", i ndryshuar organet drejtuese të Agjencisë janë:





- Këshilli Drejtues
- Drejtori Ekzekutiv

1.3. KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Agjencisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit, si dhe kompetencat e Këshillit Drejtues rregullohen përmes Ligjit Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” si dhe Vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët zgjidhen nga titullarët e Institucioneve të Administratës Publike të parashikuara në nenin 7 të Ligjit Nr.115/2017, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2022 Këshilli Drejtues, ka marrë vendimet poshtëshënuar:

- Vendim Nr.1 datë 05.01.2022 “Për miratimin e PBA 2022-2024, Raportit Vjetor për periudhën janar-dhjetor 2021, si dhe programin vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për periudhën janar-dhjetor 2022.
- Vendim Nr.2 datë 06.04.2022 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës Nr.1 datë 05.01.2022 “Për miratimin e PBA 2022-2024, Raportit Vjetor për periudhën janar-dhjetor 2021, si dhe programin vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për periudhën janar-dhjetor 2022.

1.4 DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës është autoriteti më i lartë ekzekutiv i saj. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë. Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Diasporës në marrëdhënie me të tretët.

Gjatë vitit 2022, kjo detyrë ushtrohet nga Znj.Sonila Hysi, e cila posedon statusin administrativ, Drejtues i Trupës së Nivelit të lartë Drejtues (TND).





Drejtori Ekzekutiv raporton periodikisht në Këshillin Drejtues për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

1.5 STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura administrative e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe përbëhet nga: Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Bazuar në nenin 10, shkronja b), të ligjit 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, një nga burimet financiare për realizimin e misionit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, janë të ardhurat nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

1.5.1 DREJTORIA E DIASPORËS

Drejtorja e Diasporës është përgjegjëse për:

- Koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit të saj;
- Planifikimin, organizimin dhe zbatimin e detyrimeve të lidhura me qëllimet dhe aktivitetin e Agjencisë.

1.5.2. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse për:

- Administrimin e buxhetit të miratuar dhe veprimtarinë financiare të Agjencisë;
- Përgatitjen e projekt-buxhetit dhe për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me hartimin e planit financiar buxhetor afatmesëm e vjetor me qëllim arritjen e objektivave të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

1.5.3. NJËSIA E MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE

Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse për :


- Planifikimin, drejtimin dhe zbatimin e projekteve në përputhje me misionin e institucionit dhe në nxitje të sipërmarrjes së Diasporës për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor.





- Koordinon me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës.

STRUKURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS



II. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE

2.1. STRATEGJIA KOMBËTARE E DIASPORËS 2021-2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të detyrave funksionale të saj, ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e saj të Veprimit.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 dhe Plani i Veprimit është miratuar me Vendimin Nr.585, Datë 22.07.2020 të Këshillit të Ministrave.

Kjo është Strategjia e dytë që Qeveria Shqiptare ka miratuar për marrëdhënien me Diasporën Shqiptare. Tre vite më parë u miratua Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018 – 2024, e cila ishte i pari dokument në llojin e vet. Zhvillimet dinamike sollën





nevojën për rishikimin dhe përditësimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për marrëdhënien e Shtetit Shqiptar me Diasporën.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021 – 2025 ka filluar nga Janari i vitit 2021.

Gjatë vitit 2022, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka koordinuar veprimtarinë administrative ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, si dhe ka bashkëpunuar me to për realizimin në afat të masave të Planit të Veprimit. Me qëllim zbatimin e parimit të transparencës dhe të drejtës së informimit, Agjencia ka publikuar, çdo 6 (gjashtë) muaj, Buletinin për realizimin e Planit të Veprimit të Strategjisë, i cili mund të konsultohet në linkun <http://akd.gov.al/buletini-per-masat-e-planit-te-veprimit/>.

2.2. GRUPI I KOORDINATORËVE

Gjatë vitit 2022, për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025, Agjencia Kombëtare e Diasporës është koordinuar dhe ka bashkëvepruar ngushtësisht me Grupin e Koordinatorëve, i ngritur me Urdhrin Nr. 30, datë 17.2.2021 të Kryeministrit “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën 2021-2025”.

2.3. KËSHILLI KORDINUES I DIASPORËS

Këshilli Kordinues i Diasporës është organi përfaqësues i marrëdhënieve të Diasporës me institucionet shtetërore shqiptare. Në mbledhjet e tij të rregullta marrin pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore. Ai është ngritur dhe kryen veprimtarinë e tij mbi bazën e Ligjit Nr. 16/2018 “Për Diasporën” i ndryshuar. Në përputhje me këtë ligj, Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Agjencia koordinon mbledhjet dhe takimet me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës.

Në datë 18 dhjetor 2022 u zhvillua Mbledhja Vjetore e Këshillit Koordinues të Diasporës, me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Shqipërisë, SH.T. Z. Edi Rama, Ministrave dhe krerëve të institucioneve shqiptare.





Qëllimi i zhvillimit të mbledhjes ishte forcimi i urave lidhëse ndërmjet diasporës dhe institucioneve shqiptare, duke krijuar një kuadër të plotë institucional në këtë drejtim, zhvillimin e një vizioni bashkëpunues përmes dialogut kuptimplotë dhe të strukturuar duke krijuar mundësi dhe mekanizma të qëndrueshëm për të kontribuar dhe vazhduar nxitjen e zgjidhjeve dhe programeve inovative të përshtatshme për interesat dhe aftësitë e pjesëtarëve të diasporës.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në rolin e sekretariatit teknik për koordinimin e mbledhjeve dhe takimeve të Këshillit Koordinues të Diasporës realizoi me sukses këtë funksion në koordinim të ngushtë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjithashtu, Këshilli Koordinues i Diasporës zhvilloi takime me Presidentin e Shqipërisë, SH.T. Z. Bajram Begaj, Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë si dhe me përfaqësues të mazhorancës dhe partive opozitare. Gjatë këtyre takimeve u diskutua ndër tjera rreth punës së kryer si dhe rreth prioriteteve si organ.

Një nga prioritetet kryesore është mundësimi i votimit nga jashtë Shqipërisë për shtetasit shqiptarë, e drejtë kjo që garantohet me Kushtetutën e Shqipërisë dhe Kodin Zgjedhor. KKD është pjesë e grupit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ("KQZ") për votimin nga jashtë dhe është duke ndjekur nga afër procesin e mundësimit të kësaj të drejte themelore nga KQZ.

III. SAMITI I TRETË I DIASPORËS

Ka nisur puna përgatitore për organizimin e Samitit të III të Diasporës në vitin 2023, i cili do të organizohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Samiti i III-të i Diasporës Shqiptare, i cilësuar si event i rëndësishëm, është më i madhi në kuadër të diasporës shqiptare i cili do të bëjë bashkë shqiptarët kudo në botë duke mundësuar një hapësirë diskutimi për çështje të ndryshme të politikëbërjes së shtetit





shqiptar dhe njëkohësisht këndvështrimin e Diasporës mbi impaktin e këtyre politikave, duke evidentuar sukseset e arritura dhe vështirësitë e evidentuara.

Organizimi i këtij eventit është në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe në vijim të politikës shtetërore, me qëllim forcimin e urave lidhëse ndërmjet diasporës dhe institucioneve shqiptare.

Samiti ka si pikësynim të arrijë fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve dhe është ideuar si një dritare dialoguese në infrastrukturën Diasporë –Shqipëri dhe Brainstorming nga Diaspora.

Samitin të III i Diasporës synohet të ketë impakt:

Social

Forcimi i urave lidhëse ndërmjet Diasporës dhe vendit amë;

Eksplorimi i mënyrave të reja për të nxitur zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues.

Mbështetja e organizatave të diasporës për tu institucionalizuar dhe funksionalizuar nëpërmjet programeve dhe partneriteteve në një kornizë koherente dhe të qëndrueshme.

Informimi mbi zhvillimet në kuadër të implementimit të votës së diasporë, nëpërmjet KQZ.

Ekonomik

-Përfshirje e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit të origjinës;

-Volumi i tërhequr i investimeve nga diaspora;

-Rritja e numrit të startup-eve nga diaspora shqiptare (ekosistemi i startup-eve)

-Nxitja e investimeve nga diaspora në sektorë prioritarë apo identifikimi i trendeve të reja të investimeve (infrastrukturë turistike; agroturizëm, kulinari, zeytari etj)

Kulturor

-Ruajtja e gjuhës dhe identitetit kombëtar në komunitetet shqiptare kudo në botë;

-Nxitja e atdhedashurisë;

-Veçoritë dhe karakteristikat e Diasporës shqiptare- Diaspora e hershme tradicionale & Diaspora e re.





- Promovimi i figurave dhe personaliteteve shqiptare që spikatin për histori suksesi në diasporë;
- Mekanizma dhe projekte kulturore, që nxitin bashkëveprimin midis të rinjve shqiptarë në Diasporë dhe atyre evropian apo nga Ballkani.
- Nxitja e diasporës shqiptare në zhvillimin e kërkimit shkencor, teknologjisë e inovacionit.

IV. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS GJATË VITIT 2022

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka ndërtuar një mekanizëm të vlerësimit të nevojave të diasporës i cili ka shtrirje “makro” dhe “mikro”. Programi është hartuar me kujdes, duke u bazuar në kërkesat e drejtpërdrejta të pjesëtareve të diasporës shqiptare si dhe kërkesave që rrjedhin nga zbatimi i “Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”.

Për këtë qëllim, është përdorur një metodologji bashkëkohore e kryqëzuar informacioni përmes formularëve të vlerësimit si dhe informacionit të kryqëzuar duke shfrytëzuar:

- ✓ Zbatim të objektivave që rrjedhin nga implementimi i “Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2022-2025” dhe Ligji Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” i ndryshuar;
- ✓ Realizimi i takimeve me përfaqësues të diasporës shqiptare në vendet pritëse si dhe shoqata e organizata që veprojnë në diasporë.
- ✓ Përgatitjes, mbledhjes dhe analizës së pyetësorëve për të tërhequr interesimin e çdo përfaqësuesi të diasporës në aktivitete të zhvilluara gjatë vitit paraardhës;
- ✓ Interesat e evidentuara gjatë realizimit të diskutimeve të drejtpërdrejta gjatë aktiviteteve specifike të natyrës së brainstorming të përcjella nga pjesëtarë të diasporës;
- ✓ Marrjes së mendimit të të gjitha institucioneve të interesuara për diasporën;
- ✓ Konsultave dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë.



4.1 TAKIME ME PROFESIONISTË NË DIASPORË

Në datë 15 shtator 2022, në Tiranë, Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Smart ED zhvilloi takim me 10 (dhjetë) sipërmarrës dhe profesionistë pjesë e projektit “Startup Diaspora”.

Takimi kishte si qëllim forcimin e mëtejshëm të urave lidhëse midis sipërmarrësve dhe profesionistëve në diasporë dhe institucioneve shtetërore të vendit.

Gjatë takimit u diskutua për zhvillimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta në interes të përfshirjes së të rinjve nga diaspora për të kontribuar në vendlindje me aftësitë e fituara në vendet pritëse.

U theksua se Diaspora mund të japë një kontribut të vlefshëm për Shqipërinë jo vetëm duke u kthyer fizikisht në vend, apo duke transferuar kapitalin e vet financiar, por edhe nëpërmjet njohurive dhe aftësive që ata kanë përfituar apo nëpërmjet lidhjeve që ata kanë me vendin amë.

Vlerësohet se shumë profesionistë të kualifikuar nga komunitetet shqiptare mund të ndajnë njohuritë dhe përvojën e tyre me profesionistë që jetojnë në Shqipëri, me anë të kthimit të përkohshëm në Shqipëri, apo angazhimeve në nivele akademike.

4.2 AKTIVITETE ME KOMUNITETE SHQIPTARE NË BOTË

4.2.1 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË MBRETËRINË E BASHKUAR, DATË 24-26 NËNTOR 2022

Me qëllim promovimin e gjuhës dhe traditave shqiptare, përmbushjen e misionit madhor të mësimit të gjuhës shqipe në diasporë, forcimit të ndjenjës së atdhedashurisë si dhe ruajtjes së identitetit kombëtar, konsolidimin e marrëdhënieve institucionale ndërmjet institucioneve përgjegjëse shqiptare për çështjet e diasporës dhe komunitetin Shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar, nxitjen e rrjetëzimit të profesionistëve (mjekëve) në diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës mori pjesë:



- ❖ Në datën 24.11.2022 nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar u organizua pritja me rastin e 110 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Në pritje ishte ftuar trupi diplomatik, media të ndryshme, përfaqësues të biznesit, si dhe personalitete të shquara të diasporës shqiptare të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në Londër në Mbretërinë e Bashkuar. Pritja u zhvillua nën tingujt e himnit kombëtar si dhe atmosferës festive dhe dashamirëse midis të ftuarve.
- ❖ Në datën 25.11.2022 me ftesë të shoqatës “Ardhmëria” Mbretërinë e Bashkuar, përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës realizuan një vizitë institucionale në shkollën St Agustin School, me nxënës me origjinë shqiptare të cilët mësojnë gjuhën shqipe, këngët dhe vallet tradicionale shqiptare.
- ❖ Në datën 26.11.2022 përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës morën pjesë në Konferencën e 16-të Ndërkombëtare “Për Shëndetësinë në Pandemi dhe Shkencën për të Ardhmen” të organizuar nga Shoqata “Ardhmëria” në Londër, Mbretërinë e Bashkuar në bashkëpunim me Federatën Mjekësore Shqiptare për Evropën (FMSHE). Konferenca ishte e organizuar në panele, pjesë e diskutimit ishin edhe anëtarë të Këshillit Koordinues të Diasporës. Ekspertë të fushës së shëndetësisë nga diaspora shqiptare, të punësuar në spitale të ndryshme të Europës, ndanë mendimet e tyre për mënyrat se si shtetet e ndryshme përballuan pandeminë, u evidentuan dëmet e shkaktuara, mësimet e nxjerra nga gjunjëzimi i sistemit shëndetësor në fazat e para të pandemisë, si dhe rëndësia e bashkërendimit të sistemit shëndetësor në të gjithë botën e nevoja e vaksinimit për përballjen me pandeminë.
- ❖ Në kuadër të atmosferës festive dhe kremtimit të festave të Nëntorit dhe 110 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, Shoqata “Ardhmëria”, organizoi një festë të madhe me nxënës të shkollës, të cilët të veshur me kostume kombëtare performuan nën ritmet e muzikës tradicionale shqiptare. Shfaqja filloi me himnet kombëtare të të dy vendeve dhe vijoi me tingujt e gëzuar të muzikës shqiptare.





4.2.2 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË GJERMANI

Në datën 18 nëntor 2022 me ftesë të Konsullit të Republikës së Shqipërisë në Mynih, Gjermani, delegacioni i Agjencisë Kombëtare të Diasporës mori pjesë në festimet zyrtare në kuadër të kremtimit të Festave Kombëtare të 110 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Festës Kombëtare të çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj.

Kremtimi i Festës Kombëtare u zhvillua në Sallën e Festave të Akademisches Gesangverein në Mynih, në prezencën e Presidentit të Qeverisë së Bavarisë së Sipërme, Trupit Diplomatik, Agjencisë Kombëtare të Diasporës, medias, përfaqësuesve të biznesit si dhe përfaqësues të komunitetit shqiptar në Mynih, Gjermani.

Aktiviteti u hap me himnet kombëtare të të dy vendeve dhe vijoi me tingujt e muzikës klasike shqiptare dhe të huaj të përgatitura për këtë event.

Qëllimi i aktivitetit ishte promovimi i artit, turizmit, kulturës dhe traditave shqiptare. Vlerës së këtij aktiviteti iu shtua interpretimi i shquar i artistëve shqiptarë dhe të huaj, regjisores Valbona Xibri dhe aktores ukrainase Marina Ivaschenko, me një fragment të dramës “Burrnesha”, interpretimi virtuoz i violinistit të shquar Rudens Turku dhe koleges së tij pianiste Tatiana Chernichka, si dhe grupit të valleve të Shoqatës “Iliria”.

Në Mynih, Gjermani në datën 19 nëntor 2022 u organizua simpoziumi shkencor “Sfidat dhe mundësitë e inkuadrimin të Diasporës në bashkëpunime dhe rrjetëzime shkencore kombëtare e ndërkombëtare”, organizuar nga shoqëria e akademikëve shqiptarë “Dija” e.V.

Ky simpozium shkencor bëri së bashku profesionistë shqiptarë në diasporë të fushave të ndryshme, me qëllim promovimin e shkencës, transferimin e dijes, shkëmbimin profesional si dhe rrjetëzimin e profesionistëve në diasporë.

Simpoziumi u zhvillua në panele me pjesëmarrje profesorë universitetesh të cilët ishin kthyer nga emigrimi dhe ushtronin profesionin e tyre në vendlindje. Gjatë diskutimeve



u pasqyruan vështirësitë e largimit nga vendi, përshtatja në vendin e huaj si dhe vështirësitë e rikthimit në vendin e tyre.

U theksua se tashmë profesionistët dhe biznesmenët shqiptarë në Diasporë mund të shërbejnë si faktor kontribues në shtetin e origjinës/pritës. Kjo do të realizohet duke tërhequr mendimet dhe arritjet e tyre nëpërmjet projekteve të ndryshme të zhvillimit.

Përfaqësues të GIZ Albania dhe GIZ Kosovë pas diskutimeve të tyre prezantuan një video promocionale që tregonte se si emigrantë të moshave të reja janë kthyer në Shqipëri dhe Kosovë mbështetur nga programet e GIZ.

Midis Shoqërisë së akademikëve shqiptarë “Dija” e.V dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi.

Me pjesëmarrje të personaliteteve nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës, Konsullatës së Përgjithme të Republikës së Shqipërisë në Mynih, Konsullata e Përgjithme e Republikës së Kosovës në Mynih, nga ky aktivitet arritën të evidentoheshin fushat në të cilat duhet punuar me qëllim bashkëpunimin dhe rrjetëzimin e shkencës, projektet dhe strategjitë institucionale.

4.3 DITA E DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në datë 18 dhjetor 2022, në Tiranë ka zhvilluar një program aktivitetesh kulturore me rastin e Ditës Kombëtare të Diasporës.

“Dita Kombëtare e Diasporës”, shënon një ditë të rëndësishme në fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve në diasporë.

U zhvillua Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës.

Në mbledhjen e Këshillit Koordinues të Diasporës morën pjesë Kryeministri, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme – Ministër përgjegjës për Diasporën, Zv.Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Zv.Ministri përgjegjës për Punët e Brendshme, Ministri



për Financat dhe Ekonominë, Arsimin, Kulturën, Akademia e Shkencave, Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, Qendra e Botimeve për Diasporën, si dhe përfaqësues të Qendrave Kulturore të Diasporës.

Qëllimi i mbajtjes së mbledhjes së Këshillit Koordinues të Diasporës ishte kultivimi i partneriteteve ndërmjet sektorëve dhe niveleve të ndryshme të Qeverisjes në Shqipëri, krijimi i mundësive dhe mekanizmave të qëndrueshëm për të kontribuar dhe për të vazhduar nxitjen e zgjidhjeve dhe programeve inovative të përshtatshme për interesat dhe aftësitë e pjesëtarëve të diasporës, nëpërmjet politikave gjithëpërfshirëse për diasporën, në përputhje me orientimet e politikës së integrimit të Bashkimit Evropian.

U realizua evidentimi i potencialit që diaspora shqiptare mbart në drejtim të resurseve dhe kapitalit të grumbulluar: human, social dhe kulturor.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes u krye tërheqja e këndvështrimit të Diasporës mbi impaktin e këtyre politikave (**Brain storming**).

Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës u realizua mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe në përputhje me politikat e shtetit shqiptar në fushën e Diasporës.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në rolin e sekretariatit teknik për koordinimin e mbledhjeve dhe takimeve të shtrira në një javë qendrimi të Këshillit Koordinues të Diasporës realizoi me sukses këtë funksion në koordinim të ngushtë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në kuadër të “**Javës së Diasporës**” janë realizuar:

Ekspozitë me veshje tradicionale:

Me misionin primar ruajtjen e trashëgimisë kulturore të trevave shqiptare, u realizua ekspozitë me veshje tradicionale artizanale 100% shqiptare duke ruajtur dhe tejçuar brez pas brezi vlerat e trashëgimisë së pasur kulturore të vendit tonë.

Të reja shqiptare me krenari ekspozuan Xhubletën, ‘kryevepër’ të trashëgimisë kulturore shqiptare. Xhubleta është në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale Botërore, të UNESCO –s me qëllimin që t’i përkasë jo vetëm Shqipërisë, por mbarë njerëzimit.





Mbrëmje gala

U zhvillua mbrëmje gala, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Dhomës së Biznesit të Diasporës gjatë të cilës u ndanë çmime “*Bright Minds*”- për bizneset shqiptare nga diaspora.

Aktivitet kulturor me muzikë instrumentale shqiptare

Nën interpretimin e artistit të mirënjohur z. Aulon Naçi dhe 'Mjeshtrit të Madh', z. Vendim Kapaj me fokus prezantimin dhe shpërndarjen e muzikës dhe jo vetëm, por të artit shqiptar në gjenezë nëpërmjet një formacioni me përbërje shqiptare, por që në vetvete ka dhe komponent të cilët vijnë nga një formim apo shkollim i rëndësishëm jashtë atdheut për dekada. Një aspekt thelbësor është padyshim rëndësia e origjinës dhe e së shkuarës si identitet i fortë i kulturës shqiptare brenda dhe jashtë saj.

Formacioni orkestral, ishte i nivelit të lartë të muzikës instrumentale shqiptare në rang vendi dhe botëror dhe prezantoi përmbledhje muzikore me tema si: emigracioni, natyra, nëna, kujtimet, të cilat u përmbledhën si një buqetë ngjyrash nëpërmjet ndërthurjes së artistëve me njëri- tjetrin.

Artistë shqiptar përcollën atmosferë festive me këngë e valle të kostumografise dhe folklorit shqiptar me motive tradicionale.

Në datë 19 dhjetor 2022 anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kanë vijuar takimet me:

- ▲ Deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku u diskutua për rolin e KKD-së dhe garantimi i së drejtës së votës për shtetasit shqiptar që jetojnë jashtë vendit.
- ▲ Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.
- ▲ Znj. Lindita Nikolla, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
- ▲ Z. Ilirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve

Në datë 20 dhjetor 2022 anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kanë vijuar takimet me:

- ▲ Presidentin e Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Bajram Begaj -Mbrotja dhe forcimi i marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës.





4.4 AKTIVITETE TË TJERA

4.4.1 TAKIMI NË DATË 21 QERSHOR 2022, NË AMBIENTET E PREFEKTURËS KORÇË. BASHKËPUNIMI ME PREFEKTURAT PËRKATËSE PËR TË FUQIZUAR KOMUNIKIMIN MES AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE NJVV-VE.

Në kuadër të bashkëpunimit midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Prefekturat e vendit me qëllim forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit, informimin e diasporës shqiptare mbi NJVV-të dhe funksionalitetin e tyre, ndërmjetësimi mes NJVV-ve dhe investitorëve potencialë të diasporës në datë 21 qershor 2022, në ambientet e Prefekturës Korçë u zhvillua takim lidhur me çështjet e diasporës dhe migracionit.

Në takim mori pjesë Prefektura Korçë, Agjencia Kombëtare e Diasporës, përfaqësues i Ministrit për Diasporën të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Kufirit & Migracionit Korçë si dhe Kryetari i Bashkisë Pustec.

Gjatë takimit u bë një prezantim i masave të marra në nivel kombëtar e vendor për çështjet e Diasporës dhe Migracionit dhe u trajtuan problematikat që kanë dalë gjatë procesit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planeve të Veprimit në nivel vendor. Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenin 29/1 të ligjit, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 456 datë.10.06.2020 “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, përcaktohen qartë funksionet e Bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit.

Ndër Bashkitë që kanë miratuar Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën përmendim: Tiranë, Korçë, Kukës, Dibër.

Qëllimi i Planit Vendor të Veprimit për Migracionin është është hartimi i një platforme me objektiva strategjike dhe masa të zërthyera në projekte konkrete që do të hedhin bazat e sistemeve informuese dhe bashkërenduese, mbi migracionin dhe diasporën duke garantuar, riintegrim të qendrueshëm dhe bashkëpunim frytdhënës me diasporën.





Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 synon harmonizimin e planeve vendore dhe atyre sektoriale zhvillimore të cilat zbatohen nga ministritë e linjës, duke i dhënë diasporës një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik. Përfshirja e diasporës në këtë kontekst do të realizohet në përputhje me synimet dhe interesat e vetë komunitetit të diasporës.

Masa Nr. 39 Planit Veprimit të Strategjisë për vitin 2022 përcakton shprehimisht:

Krijimin e strukturave administrative në pushtetin lokal për informimin dhe mbështetjen investimeve nga të interesuarit në diasporë. Ky informim i diasporës do të jetë i koordinuar për mundësitë e investimeve në Shqipëri për motivimin e bizneseve apo migrantëve shqiptarë për të investuar në sektorë të veçantë të ekonomisë.

U shkëmbyen mendime rreth praktikave më të mira të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore" dhe u ftua bashkëpunim i ngushtë me kolegët e Maqedonisë së Veriut të vizitojnë zyrat e informacionit për diasporën që operojnë në bashkitë e vendit tonë për bashkëpunim të afërt me qytetarët, zhvillim të projekteve ekonomike dhe social e kulturore etj.

Nga palët u shpreh gatishmëria për bashkëpunim e shkëmbim eksperiencash në këtë fushë, duke filluar nga trajnimi i stafëve përkatëse, deri në arritjen e objektivit kryesor që është krijimi i urave të bashkëpunimit me aktorë influentë të diasporës, si dhe orientimi e integrimi me të drejta të plota e të barabarta i të gjithë qytetarëve, pavarësisht vendndodhjes të tyre.

4.4.2 AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS BËHET PJESË E KONFERENCËS KOMBËTARE TË NIVELIT TË LARTË ME TEMË "VOTIMET NGA JASHTË, KOHA ËSHTË TANI!".

Ne datë 24 Maj 2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri OSCE Presence in Albania organizoi Konferencën Kombëtare të Nivelit të Lartë me temë "Votimet nga jashtë, koha është tani!"



Ky aktivitet bashkoi partitë politike, institucionet shtetërore, diasporën, shoqërinë civile dhe komunitetin ndërkombëtar, për të hedhur piketat e mundësimit të ushtrimit të votës së shqiptarëve nga jashtë vendit në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025.

Mesazhe të rëndësishme për implementimin e votimit nga jashtë dha Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Vincenzo Del Monaco, Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, zj. Lindita Nikolla, Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zj. Yuri Kim dhe Zëvendëshefi i Seksionit Politik i Delegacionit të Bashkimit Evropian, z. Jean-Baptiste Le Bras, Zv.Ministre për Evropën dhe Punët e Jashtme znj.Artemis Malo.

Pjesë e Konferencës ishte dhe Agjencia Kombëtare të Diasporës, ku theksua rëndësia e implementimit të votimit nga jashtë vendit, ku ka si kusht të domosdoshëm pasjen e një konsensusi politik, gjithëpërfshirës, mbi çdo aspekt përgatitor dhe realizues.

Votimi nga jashtë, veçanërisht në zbatimin për herën e parë të tij, ka si kusht të domosdoshëm pasjen e një konsensusi politik, gjithëpërfshirës, mbi çdo aspekt përgatitor dhe realizues.

KQZ është e vendosur dhe e ka bindjen e plotë se përmbushja e përgjegjësiave të saj institucionale në lidhje me votimin nga jashtë, nuk mundet të jetë e plotë dhe e dobishme nëse në rrugën e përmbushjes së tyre ne nuk konsiderojmë të gjithë faktorët e interesuar në këtë proces.

Partitë politike, organizatat e shoqërisë civile, institucione dhe organizatat partnere ndërkombëtare shkëmbyen ide mbi realizimin dhe mënyrat e votimit të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, duke marrë shembuj të praktikave të konsoliduara të vendeve të tjera. Gjithë kuadri rregullator për votimin nga jashtë do të konsultohet që në fazën e draftimit me të gjithë grupet e interesit, përfshi këtu edhe partitë politike. KQZ synon që këtë proces ta përfundojë jo më vonë se vjeshta e vitit që vjen.

Në përfundim të punimeve të konferencës, KQZ së bashku me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri propozuan një draft rezolutë me gjetjet dhe rekomandimet e eventit.

4.4.3 AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS PJESË E SAMITIT TË GRUAS NË BIZNES



Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare mbajti në datë 23.09.2022, në Tiranë, Samitin e tretë të grave të biznesit të diasporës me temë “Gruaja për zhvillim të qëndrueshëm”. Në event u mbledhën rreth 100 gra sipërmarrëse dhe drejtuese të organizatave të ndryshme nga Shqipëria dhe Kosova.

Pjesë e aktivitetit ishte dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës, nga e cila u theksua kontributi institucional i dhënë në forcimin e rolit të gruas në diasporë. Projekt-propozimet, të cilat synojnë dhe kanë prioritet fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri, në biznes, në kulturë, duke vendosur një theks të veçantë në promovimin e aftësive sipërmarrëse të grave në diasporë, krijimin e një klime favorizuese për rritjen e numrit të grave sipërmarrëse si dhe stimulimin e investimeve nga diaspora nëpërmjet ekosistemit të startup-eve. Angazhimi institucional në rritjen e bashkëveprimit me shoqata, organizata, Unione të grave në diasporë, do të jetë i vazhdueshëm për arritjen e këtij qëllimi.

V. DATAZA E STUDENTËVE

“Baza e të Dhënave Shtetërore të Studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë” është produkt i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, "Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, është ngritur sistemi i brendshëm i databazës.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme.





Agjencia Kombëtare e Diasporës ka ngritur një grup pune për hedhjen e të dhënave në databazë. Aktualisht kërkesës për informacion është përgjigjur vetëm Ministria e Arsimit, e cila ka dërguar një format i cili nuk përputhet me të dhënat parësore. Në bazë të komunikimeve, Ministria e Arsimit në vazhdim do të sjelli listën sipas formatit që i përshtatet sistemit të brendshëm.

Baza e të dhënave shtetërore përmban të dhëna personale, parësore dhe dytësore të shtetasve shqiptarë, të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendit, të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë dhe shtetasve shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

Portali përbën zhvillimin e një sistemi informatik për automatizimin e procedurës së përfitimit të bursave të studimit nga Republika e Shqipërisë, i cili është në zbatim të politikave të institucionit dhe konsiston në përmirësimin e procesin e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë”.

Kjo është një nismë e cila ka në fokus rritjen e ndërveprimit me studentët duke lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre. Ajo u vjen në ndihmë studentëve shqiptarë në diasporë duke iu ofruar mundësinë për të kapërcyer barrierat gjeografike. Data baza e studentëve shqiptar në diasporë është një portal që synon të mbështesë e të nxisë zhvillimin e Shqipërisë duke ofruar një "Urë Komunikimi për Diasporën" duke ofruar të dhëna mbi studentët, degët dhe vendin ku studiojnë, analiza statistikore, forumin i cili përfshin interaktivitetin me qëllim që studentët të komunikojnë me njëri-tjetrin.





VI. SEKTORI I PROJEKTEVE

Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:

- Për planifikimin, drejtimin dhe zbatimin e projekteve në përputhje me misionin e institucionit dhe në nxitje të sipërmarrjes së Diasporës për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor.
- Koordinon me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës.

VII. KOORDINIM ME DONATORËT E PROJEKTEVE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE DHE VEPRIMTARISË SË AKD-SË

7.1.1. PROJEKTI FORM@2

Në datë 25.10.2022 u zhvillua Tryezë e Rrumbullakët për prezantimin e rezultateve të projektit “Form@2”, si dhe një shikim mbi emigracionin shqiptar 31 (tridhjetë e një) vjeçar në Itali,

Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte pjesë e diskutimeve të Tryezës së Rrumbullakët të zhvilluar në kuadër të këtij projekti.

Projekti Form@2 ka filluar në tetor 2020, ka trajnuar mbi 50 persona në Shqipëri për të cilët është kontribuar në mësimin e gjuhës italiane, për të drejtat dhe detyrat kushtetuese dhe sigurimi i instrumenteve të orientimit dhe integritit në shoqërinë italiane. Operatorët kanë mbështetur ndër të tjera familjet për marrjen e vizës në strukturat konsullore. Pavarësisht vështirësive operative të një projekti të nisur në një krizë të plotë pandemike, objektivat janë arritur në të gjitha vendet e përfshira (Shqipëri, Egjipt, Tunizi, Marok e Senegal) ku janë trajnuar në total mbi 2000 persona.

U evidentuan lidhjet e hershme kulturore, gjeografike, ekonomike midis vendeve tona, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis Italisë dhe Shqipërisë. Projekti Form@2 çmohet me rëndësi pasi përmbush misionin e orientimit dhe integritit në shoqërinë italiane, të





shtetasve të cilët dëshirojnë të kryejnë bashkim familjar, ndihmon bashkëshortë, prindër, fëmijë që kanë aplikuar në procedurën përkatëse.

Në këtë kuadër Projekti Form@2 paraqet një hap të rëndësishëm. Pra sikurse u theksua, marrëdhëniet me vendin fqinjë janë të hershme dhe ekziton një lidhje e fortë midis dy vendeve tona, popujve dhe organeve qeverisëse.

Italia paraqet një partner strategjik, mjafton të hedhim një vështrim në sipërmarrjet me investim italo-shqiptare apo italiane që operojnë në Shqipëri.

Tryeza u përshëndet nga SH.T.Z.Ambasadori Italian në Shqipëri z. Fabrizio Bucci.

Pjesë e Tryezës së Rrumbullakët ishin autoritetet italiane dhe shqiptare: SH.T.Z. Ambasadori Italian në Shqipëri z. Fabrizio Bucci, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Patronato Inas Cisl znj. Liliana Ocim, z. Marco Calavetto, Patronato Acli dhe patronato inca CGIL, znj. Tatiana Esposito, (Znj. Beskida Aliaj, z. Abele Bejko, Francesca Grassi, Koordinatorë), përfaqësues nga bota akademike Prof. Arjeta Veshi, z. Dashamir Uruci President i Unionit Shqiptar të Shoqërisë Civile, si dhe shoqatat e diasporës shqiptare.

Znj. Tatiana Esposito, solli në vëmendje mundësinë e projekteve në të ardhmen në fushën e emigracionit, midis dy vendeve.

7.2. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS PJESË E PROJEKTIT RAJONAL “MARGINAL RESILIENCE: THE CIRCULAR ECONOMY MODEL FOR THE ENHANCEMENT OF TERRITORIAL VOCATIONS”.

Në kuadër të projektit Rajonit Puglia në Itali “Marginal resilience: the circular economy model for the enhancement of territorial vocations” me propozues Regione Puglia – Coordinamento delle Politiche Internazionali dhe kohëzgjatje 36 muaj, janë zhvilluar takime virtuale dhe fizikisht ndërmjet palëve pjesëmarrësve në projekt: Noè Andreano, Kryetar i Komunës Casalvecchio në Puglia, përfaqësuese e Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë, Drejtues i Zyrës së Koordinimit në Tiranë, Agjencia Kombëtare e



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**

Diasporës, përfaqësues nga Bashkia Vlorë dhe të entit propozues të Projektit, si dhe përfaqësues të kulturës nga Rajoni Puglia.

Objektiv i projektit është Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, punësimi i plotë dhe produktiv dhe puna e denjë për të gjithë. Zhvillimi në të gjithë nivelet të institucioneve efikase, të përgjegjshme dhe transparente, promovimi i shoqërive paqësore etj.

Agjencia Kombëtare e Diasporës do të kryejë rolet, funksionet dhe aktivitetet e mëposhtme:

- mbikëqyrja në fazën kushtuar ri-dhënies së grantit me qëllim forcimin e angazhimit të Diasporës dhe komuniteteve Arbëreshë në proceset e zhvillimit territorial në target zonën e synuar në hqipëri;
- hartimin dhe menaxhimin e thirrjes për ri-dhënie të grantit;
- zbatimin e aktiviteteve të projekteve të financuara nga ri-dhënia e grantit
- garantimi i përafrimit të veprimeve të projektit me politikat e miratuara nga qeveria shqiptare për vlerësimin e diasporës dhe komuniteteve Arbëreshë
- zbatimin e aktiviteteve veçanërisht në fazën e përfshirjes së shoqatave dhe organizatave të migrantëve (arbëreshë) aktivë në territorin e Puglias.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka mbështetur me të dhëna Drejtuesin e Zyrës së Koordinimit në Tiranë z. Claudio Polignano, në kuadër të projektit në drejtim të shoqatave dhe organizatave arbëreshë vepruese në Rajonin e Puglias.

VIII. MARRËVESHJE DHE MEMORANDUME

Agjencia Kombëtare e Diasporës, gjatë vitit 2022 ka nënshkruar disa marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi mbështetur në ligjin organik Nr.115/2017, Neni 6 pika 7:

Janë finalizuar Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë:





- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqërisë së Akademikëve Shqiptarë – DIJA E.V. me qëllim rrjetëzimin dhe nxitjen e bashkëpunimit me diasporën shkencore.

Me Shoqërinë e Akademikëve Shqiptarë – DIJA E.V në Mynih janë hedhur hapat drejt evidentimit dhe promovimit të diasporës shkencore dhe profesionistëve në diasporë. AKD ka krijuar dhe përditëson të dhënat dhe promovon në faqen zyrtare të saj dhe në social network profesionistë shqiptar në diasporë.

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare.

Me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare- është bashkëpunuar në kuadër të realizimit të eventeve me rastin e Ditës Kombëtare të Diasporës, e emërtuar “JAVA E DIASPORES” dhe synohet të shtrihet bashkëpunimi këtë vit, në evidentimin e bizneseve dhe nxitjen e investimeve nga diaspora

- **Marrëveshje bashkëpunimi lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi,** me Nr. 203/1Prot. datë 23.12.2022 me objekt nxitjen e bashkëveprimit institucional me diasporën shqiptare në Greqi për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit, të gjuhës shqipe dhe trashëgimisë kulturore kombëtare.

Me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Greqi- është bashkëpunuar në funksion të komunitetit më të madh shqiptar të ngritjes së një Qendre Kulturore në Athinë, në aktivitete kulturore.

Ne kuader te kesaj Marreveshje eshte akorduar mbeshtetje financiare per nga fondet e Agjencise Kombetare te Diaspores me vleren 10,000,000 Leke për ngritjen e Qendrës Kulturore në Athinë, Greqi.

IX PUBLIKIME

9.1 BULETINI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT





Publikimi i buletineve gjashtë mujorë shërben si një praktikë bazuar në parimin e transparencës dhe nxit llogaridhënien institucionale. Ai bën publike punën e Agjencisë Kombëtare të Diasporës përpara një komuniteti jo prezent në vendlindje, siç është diaspora shqiptare.

9.2 REVISTA INFORMATIVE PËR BURSAT PËR DIASPORËN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹

Revista e bursave për Diasporën në Republikën e Shqipërisë është një botim i veçantë elektronik, i cili përmbledh aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara lidhur me bursat për studentët e Diasporës në Republikën e Shqipërisë. Revista mund të konsultohet në linkun: [Bursat për Diasporën në Republikën e Shqipërisë \(fliphtml5.com\)](http://Bursat%20p%C3%9Br%20Diaspor%C3%9Bn%20n%C3%9B%20Republik%C3%9Bn%20e%20Shqip%C3%9Bris%C3%9B%20(fliphtml5.com))

9.3 NEWSLETTER PËR DIASPORËN

“Newsletter e Diasporës” është një buletin informativ javor i cili pasqyron aktivitetet e institucioneve të Diasporës. Qëllimi i kësaj nisme është informimi i publikut të gjerë mbi ecurinë e praktikave që kanë lidhje me diasporën shqiptare. “Newsletter e Diasporës” mund të konsultohet në linkun: diaspora.gov.al/newsletter-2/



X. MANUAL PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË STUDENTËVE

Manuali është një botim i veçantë elektronik, i cili përmbledh aktet rregulluese për krijimin e Bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë dhe shtetasve shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit, të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë. Manuali mund të konsultohet në linkun <https://online.fliphtml5.com/asgg/ezzw/#pw1>

XI. RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

11.1. ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2022

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2022 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2019-2025 dhe Planit të Veprimit.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2022 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në zbatim të Vendimit Nr.81, datë 09.02.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, Agjencia Kombëtare e Diasporës përfshihet në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Bazuar në shkresën 13876/2 datë 27.07.2022, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2022, i është transferuar fondi buxhetor prej 42,568,937 (dyzet e dy milion e





pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë, i detajuar si më poshtë:

- Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore) 11,336,846 lekë;
- Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime) 31,132,091 lekë;

Gjithsej 42,468,937 lekë

Nr.	SHPENZIMET KORRENTE	SHPENZIMET	%
1	Shpenzime Kancelarie	95,200	0.65
2	Shpenzime Bojra Printeri dhe mirembatje të paisjeve të zyrës	105,600	0.72
3	Shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit	5,000	0.03
4	Shpenzime poste	2,215	0.02
5	Shpenzime telefonike	28,107	0.19
6	Shpenzime interneti	30,000	0.20
7	Shpenzime pastrimi	240,000	1.63
8	Takim Institucional në kuadër të projektit "Startup Diaspora"	35,000	0.24
9	Takim në kuadër të festave të Nëntorit në Londër	885,198	6.02
10	Takim në kuadër të festave të Nëntorit në Mynih Gjermani	351,377	2.39
11	Dita e Diasporës		
11.1	Shpenzime akomodimi	263,700	1.79
11.2	Shpenzime pritje përcjellje (Darke e KKD me Ministren për Europën dhe Punët e Jashtme)	151,100	1.03
11.3	Darke Gala sipas marreveshjes me Dhomen e Biznesit të Diasporës	1,774,500	12.07
11.4	Dreka	139,500	0.95
11.5	Coffee Break	85,000	0.58
11.6	Ambiente në kuadër të Ditës së Diasporës (Plaza Hotel)	415,000	2.82



12	Mbështetjen Financiare të Menjëherdhme të Punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjishme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për Zbutjen e Impaktit të Krizës	100,000	0.68
13	Mbështetje financiare për ngritjen e Qendrës Kulturore në Athinë, Greqi	10,000,000	68.00

11.2.1. SHPENZIME PËR FONDIN E PAGAVE DHE SIGURIMEVE (LLOGARIA EKONOMIKE 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 10 punonjës, nga 16 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 4,375,673.00 (katër million e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë nga vlera prej 9,904,046.00 (nëntë million e nëntëqind e katërmijë e dyzet e gjashtë) lekë e fondit të miratuar ose 44 % e fondit të planifikuar për vitin 2022 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 849,300 (tetëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind) lekë, ose 59 %, e planifikimit për periudhën respektive.

11.2.2. SHPENZIMET KORRENTE (MALLRA DHE SHËRBIME, LLOGARIA EKONOMIKE 602)

Për vitin 2022, fondi i shpenzime korrente është realizuar në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe dhe kanë konsistuar në:



- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
- Realizimin e shpenzimeve për realizimin e aktivitetit të ditës së Diasporës bazuar në Vendimin Nr.320, datë. 15. 05. 2019 " Për Statusin e Anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës".
- Mbështetje financiare për ngritjen e Qendrës Kulturore në Athinë, Greqi në mbështetje të Vendimit Nr.470 date 26.07.2018 "Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrave Kulturore për Diasporen" dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi.

11.2.3. 3.SHPENZIME PËR MBËSHTETJE FINANCIARE (LLOGARIA EKONOMIKE 606)

Në zbatim të Vendimit nr. 898 datë 29.12.2022 “Për Mbështetjen Financiare të Menjëherdhme të Punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjishme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për Zbutjen e Impaktit të Krizës”, Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi shpenzimin e fondit rezervë në vlerën prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.

11.3. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI)

11.3.1. FINANCA

Gjatë kësaj periudhe sektori i financës ka evidentuar me përpikmëri nëpërmjet kontabilizimeve në ditarët përkatës (ditari i magazinës si dhe shpenzimeve të arkës dhe të bankës) të gjitha shpenzimet e kryera në valutë si edhe në lekë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar si dhe udhëzimin në zbatim të tij dhe kontrollin, sektori i financës ka përgatitur të gjitha urdhër-shpenzimet në afatin e caktuar për faturat e paraqitura nga kryerja e prokurimeve publike, pagesat për pagat, honoraret dhe dietat e punonjësve. Janë përgatitur dhe likujduar 75 urdhër shpenzime. Janë përgatitur brenda afatit të gjitha listë pagesat për pagat si dhe listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat e pagave të punonjësve nëpërmjet listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve të gjeneruara nga sistemi HRMIS.

Bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”, në fund të vitit kryhet inventarizimi i aktiveve.



Janë përgatitur raportimet periodike për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, rakordimet me Degën e Thesarit si dhe çdo informacion tjetër me karakter financiar.

11.3.2. BURIME NJERËZORE

Struktura e re e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratur me Urdhërin Nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Marrëdhëniet e punës për Drejtorin Ekzekutiv dhe nëpunësit e Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në realizimin e objektivave kryesorë institucionalë. Në këtë kontekst, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka patur si objektiv prioritar jo vetëm ngritjen e kapaciteteve të brendshme por dhe ruajtjen e një strukture organike që do ti mundësonte eficiencë në realizimin e misionit të saj. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është i orientuar drejt administrimit me korrektësi të dosjeve të personelit, si dhe vlerësimit vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse si dhe identifikimit të nevojave të personelit për përmirësimin e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të vendit të punës me qëllim përballimin e sfidave të ndryshme në të ardhmen.

Janë zhvilluar trajnime të ndryshme për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), European Institute of Public Administration (EIPA). Temat e trajnimeve kanë qenë gjithëpërfshirëse, si : “Menaxhimi i riskut, si instrument kryesor i zhvillimit të brendshëm”, “Risqet gjatë procesit prokurimit, implementimit fizik dhe njohjes së kostove të projekteve me financimin e BE”, “Sistemi i rishikimit në prokurimet publike dhe e drejta e ankimimit”, “Procesi i formulimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave antikorrupsion”, “Treguesit dhe përdorimi i tyre në dokumentat strategjikë”, “Roli i Kuvendit të Shqipërisë në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së”, “Working with complexity”, etj.



Për të mundur realizimin me eficiencë të objektivave dhe misionit të institucionit, në bashkëpunim me DAP-in, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore janë ndjekur procedurat për plotësimin e vendeve vakante.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në perputhje me Ligjin “Për nëpunësin civil”, ka realizuar përgatitjen e dosjeve të personelit, si dhe raportime periodike në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Gjatë këtij viti në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, autoriteti përgjegjës ka ndjekur depozitimin në kohë të formularit të Deklarimit të Interesave Privatë Periodik/Vjetor për subjektet që kanë detyrim deklarimi.

11.3.3. PROTOKOLLI

Në bazë të ligjit “Për Arkivat”, është bërë pritja e shkresave të hyra në institucionin, duke i vendosur kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjelljen e tyre drejt drejtuesit të Institucionit, i cili bën shpërndarjen e shkresave sipas drejtorive përkatëse. Është kryer procedura ligjore për shkresat dalëse të institucionit tonë, duke verifikuar fillimisht plotësimin e kushteve dhe parametrave që përcakton ligji ynë në pjesën e ndërtimit të shkresave, vendosjen e numrit të protokollit, dërgimit të tyre drejt drejtuesit të Institucionit për firmosje dhe vulosje dhe së fundmi klasifikimin e dokumenteve sipas strukturave organizative të institucionit.

11.3.4. MAGAZINA

Në hyrjen dhe shpërndarjen e artikujve nga magazina është ndjekur procedura ligjore duke bërë evidentimet e nevojshme në fletë-hyrjet, fletë-daljet dhe janë bërë pasqyrimet në Librin e Magazinës për sasi të artikujve të dala nga magazina dhe gjendjen e tyre të mbetur në magazinë.

Në fund të vitit është kryer inventarizimi i aktiveve bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”.

11.3.5. PROKURIME

Në zbatim të planit për shpenzime, AKD ka hartuar e zbatuar regjistrin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2022 është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlera të vogla, si dhe blerjeve nën 100.000 lekë pa tvsh. Bazuar në ligjin Nr. 162 datë



23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, VKM nr.28/2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe udhëzimeve përkatëse në periudhën Janar-Dhjetor janë kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik me objekt të ndryshëm prokurimi duke përfshirë “Blerje bileta transportit ajror ndërkombëtar”, “Blerje bojra printeri”, “Blerje materiale kancelarie”, “Blerje produkte promocionale”, “Shërbim mirëmbajtje dhe riparimi të printerave dhe fotokopjeve”, etj.

Janë krijuar në sistemin elektronik të APP-së gjithsej 9 procedura prokurimi, nga të cilat 4 janë anuluar për shkak të mos paraqitjes së ofertave nga operatorët ekonomik si dhe mungesës së dokumentacionit të rregullt nga ana e operatorëve ekonomik dhe janë rihedhur për arsye se dokumentet e tenderit pëmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme dhe në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme, ndërsa 5 procedura prokurimi u realizuan me sukses.

SFIDA NË TË ARDHMEN

A.PROGRAMI ME KOMUNITETET SHQIPTARE

Në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe duke patur parasysh implementimin me sukses të aktiviteteve në diasporë në disa shtete ku është vendosur diaspora shqiptare, Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin 2023 ka planifikuar të zgjerojë aktivitetet e saj në një numër më të madh vendesh, kryesisht në vendet që kanë një numër të madh të përqëndruar të diasporës shqiptare. Aktivitetet dhe takimet që synohen të zhillohen janë konceptuar si “Java shqiptare” dhe do të fokusohen në target grupet i identifikuar si dhe në rrjetëzimin e profesionistëve.





➤ **OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN NËPËRMJET PROGRAMIT**

1. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me diasporën;
2. Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së diasporës në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
3. Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me komunitetet shqiptare në botë;
4. Nxitja e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet investimeve nga diaspora;
5. Ruajtja e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare si dhe zhvillimi i identitetit të pjesëtarëve të diasporës
6. Pasurimi i bazës së të dhënave të diasporës shqiptare;
7. Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
8. Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.

➤ **TARGET GRUPET**

1. Komunitetet e hershme dhe të reja shqiptare në Diasporë;
2. Komuniteti i grave shqiptare në biznes;
3. Shoqatat e kërkuesve shkencorë dhe akademike (brain gain dhe brain drain);
4. Rrjetëzimi i profesionistëve në Diasporë nëpërmjet shoqatave të mjekëve, juristëve, artistëve, biznesmenëve, etj;
5. Shoqatat, organizatat, grupet lokale dhe rrjetet e krijuara nga Diaspora shqiptare;
6. Forumet e të rinjve të lindur/rritur në diasporë.

➤ **IMPAKTI**

Nisur nga nevoja e diktuar për angazhimin e diasporës në vendlindje si një mënyrë e re veprimi në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për kontributin e tyre, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka planifikuar programin vjetor të aktiviteteve i cili do të ndikojë jetën ekonomike, sociale, politike, kulturore të vendit nëpërmjet angazhimit të diasporës.

Programi përcakton një vizion të qartë, prioritetet dhe mënyrën për t'u lidhur dhe angazhuar me diasporën në zhvillimin e vendlindjes duke përdorur një qasje fleksibël zbatimi dhe partneriteti, duke iu referuar gjithashtu angazhimit të përgjithshëm politik të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

➤ **PRITSHMËRITË**





1. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve të forta emocionale, ekonomike, sociale dhe kulturore me komunitetet shqiptare në botë;
2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngjalljes së ndjenjës së atdhedashurisë për vendin e origjinës;
3. Nisma të inicjuara nga bizneset e diasporës për investime në vendin amë;
4. Pasurimi i bazës së të dhënave me pjesëtarë të rinj nga diaspora e të gjithë target grupeve.
5. Evidentimi i problematikave me të cilat përballlet diaspora dhe referimi për trajtim në strukturat përkatëse;
6. Forcimi i besimit ndaj institucioneve të vendlindjes;
7. Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.

➤ **METODOLOGJIA**

1. Takime me përfaqësues dhe personalitete të njohur nga bota akademike dhe politike nëpërmjet takimeve në vendet pritëse që Agjencia do të mundësojë me këto target grupe.
2. Organizimi i manifestimeve kulturore të natyrës patriotike dhe tradicionale në disa prej shteteve pritëse.
3. Krijimi i programeve të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve nga radhët e diasporës, nisur nga mirëintegrimi i tyre në vendin e pritjes dhe nevoja për përthithjen e potencialit që ato zotërojnë duke i vendosur në shërbim për vendin e origjinës.
4. Një përqindje e madhe e diasporës sonë është integruar shumë mirë në vendet ku jeton dhe nga kjo diasporë është krijuar një potencial shumë i madh i kapitalit njerëzor dhe ekonomik. Prandaj, integrimi i diasporës në vendet ku jeton dhe vepron është edhe një aspekt i rëndësishëm për marrëdhëniet ndërshtetërore për vendin tonë, duke e përdorur kështu diasporën si partner ndërmjetësues.
5. Organizimi i vizitave me grupe të rinjsh nga komunitetet shqiptare në diasporë, me qëllim njohjen e tyre me Shqipërinë: gjuhën, traditat, vizitë në objekte kulturore e historike.
6. Aktivizimi i rolit të institucioneve në promovimin e vlerave që ndikojnë në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kulturor e gjuhësor;
7. Mobilizimi i organizatave të biznesit në diasporë, duke i orientuar ato me politikat shtetërore dhe instrumentet, në mënyrë që ato të shndërrohen në ura lidhëse midis interesave të diasporës dhe bizneseve vendase. Këto aktivitete do të përqendrohen në dhënien përparësi të organizatave të biznesit dhe shoqatave brenda vendeve pritëse me bizneset më të mëdha të diasporës.
8. Fushata informuese për të drejtat; mundësitë dhe obligimet në shtetin e origjinës. Nisur nga fakti se institucionet përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën janë institucione relativisht të reja, është në proces krijimi i një





- pakete më të plotë institucionale; Njohja e diasporës me politikat e ndërmarra shtetërore për garantimin e së drejtës së votës jashtë vendit me qëllim përfshirjen e jetës së saj në jetën politike të vendit;
9. Hartimin e bazës së të dhënave përmes mbledhjes sistematike, gjithëpërfshirëse dhe hartëzimin e diasporës si dhe përfshirjen e një game të gjerë të anëtarëve të diasporës në praktika konsultimi nëpërmjet së cilës do të arrihet të kuptohet se çfarë ofron diaspora, çfarë është e gatshme të ofrojë, dhe çfarë pritët në këmbim nga qeveria.
 10. Anëtarët e Diasporës në mbarë botën konsiderohen si forcë lëvizëse dhe potenciali i diasporës mund të dalë në pah vetëm nëse ekzistojnë mekanizma të përshtatshme angazhimi, dhe nëse organizatat dhe organet e tyre përfaqësuese fuqizohen për t'u bërë pjesë e një marrëdhënie të besueshme ndërmjet diasporës, institucioneve dhe publikut të gjerë në vend.
 11. Bashkëveprimi i ngushtë me organizatat dhe shoqatat e diasporës, të cilat përfaqësojnë zërin e anëtarëve të diasporës në vendet pritëse, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në proceset strategjike vendimmarrëse në Shqipëri, si dhe mund të nxisin nisma të çmuara për bashkëveprimin shoqëror, ekonomik dhe intelektual ndërmjet diasporës dhe Shqipërisë.

A. PROGRAMI VJETOR PËR KOMUNITETET SHQIPTARE

Programi vjetor i Aktiviteteve dhe takimeve në diasporë është planifikuar të zhvillohet kryesisht në vendet që kanë një numër të madh të përqëndruar të diasporës shqiptare.

Në mbrojtje të traditës dhe identitetit kombëtar komuniteteve shqiptare është planifikuar një program i gjerë aktiviteteve i cili do të jetë i shtrirë në një hapësirë kohore rreth një javë në çdo shtet. Aktivitetet dhe takimet që synohen të zhvillohen janë konceptuar si “Java shqiptare” dhe do të fokusohen në target grupet i identifikuar si dhe në rrjetëzimin e profesionistëve dhe konsiston në takime me përfaqësues dhe personalitete të njohur nga bota akademike, politike, e biznesit e me gjerë si dhe vizita në qendrat kulturore dhe shkollat shqipe në komunitetet shqiptare.

Struktura e programeve do të përfshijë aktivitete dhe takime në komunitetet e hershme dhe të reja shqiptare në Diasporë;





Gjithashtu nisur nga nevoja e diktuar për angazhimin e diasporës në vendlindje si një mënyrë e re veprimi në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për kontributin e tyre Agjencia Kombëtare e Diasporës ka planifikuar programin vjetor të aktiviteteve i cili do të ndikojë jetën ekonomike, sociale, politike, kulturore të vendit nëpërmjet angazhimit të diasporës, I cili konsiston në;

- Takim mbi Remitancat
- Takim me profesionistë shqiptarë në fushën e mjekësisë
- Takim me gratë që spikasin për histori suksesi
- Takim me rrjetin e avokatëve/juristëve
- Tryezë e rrumbullakët me Bizneset shqiptare
- Takime dhe aktivitete në Komunitetin Arbëresh
- Studim dhe simpozium shkencor mbi veshjet/etnografinë
- Takim me forumet e të rinjve të lindur/rritur në diasporë

B. AKTIVITETE TË BASHKËRENDUARA ME MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

Samiti i III-të i Diasporës Shqiptare

Në vitin 2023 në Tiranë do të zhvillohet Samiti i III-të i Diasporës.

Samiti do të konsistojë në një seancë plenare dhe aktivitete për të ftuarit si dhe panele të dedikuara në pune tematike, nën drejtimin e ministrave të linjës.

Objektivi kryesor i këtij samiti, është që të rienergizojë bashkëpunimin me Diasporën pas viteve të vështira të pandemisë ku për shkak të kufizimeve angazhimi i Diasporës ka qenë më i vështirë. Samiti do të synojë që të vërë në lëvizje disa forma konkrete bashkëpunimi në fusha si rinia, arsimi, shëndetësia, biznesi, ti cilat do të synojnë të ndërtojnë ose të fuqizojnë network-et e Diasporës shqiptare kudo në botë.

Në mbështetje të Samitit, Agjencia Kombëtare e Diasporës propozon një program të gjerë kulturor dhe etnografik në kuader të zhvillimit të tij.

Dita e Diasporës

Takimi zyrtar i Këshillit të Koordinimit të Diasporës

Në datën 18 dhjetor 2023 do të mbahet dhe takimi zyrtar i Këshillit Koordinues të Diasporës.

Mbledhja do të zhvillohet në Tiranë në “Ditën Kombëtare të Diasporës”, që shënon një ditë të rëndësishme në fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve në diasporë.





Në këtë aktivitetet marrin pjesë Kryeministri, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme –Ministër përgjegjës për Diasporën, Ministri përgjegjës për Punët e Brendshme, për Financat dhe Ekonominë, Arsimin, Kulturën, Akademia e Shkencave, Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë, Radiotelevizioni Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe përfaqësues të Qendrave Kulturore të Diasporës. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe Ministrin përgjegjës për diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Vizitë në vendin amë

Organizimi i një vizite me grup të rinj nga komuniteti Arberësh në Itali me qëllim njohjen e tyre me Shqipërinë: gjuhën, traditat, vizitë në objekte kulturore e historike. Mundësimi i kësaj vizite ka për qëllim riaktivizimin e ndjenjës së atdhedashurisë, ndaj rrënjëve të tyre, duke i ardhur në ndihmë vlerës më të madhe që ata mbartin në ruajtjen më së miri prej më shumë se gjysëm shekullisi të gjuhës dhe traditave shqiptare, si dhe shmangien e riskut të asimilimit të kësaj vlere madhore.

PËRMBYLLJE

Raporti i vitit 2022 është dokumenti gjithëpërfshirës i punës dhe veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Përfundimi i këtij viti, nuk mund të ishte i tillë pa angazhimin e çmueshëm të stafit të Agjencisë, partneritetin e të gjithë aktorëve publik dhe privat, vendas e ndërkombëtar.





**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**

Për vitin 2022 vendosim theksin në domosdoshmërinë e realizimit të detyrës me përkushtim, me synim rritjen e bashkëpunimit me Diasporën dhe përfshirjen e saj aktive në këshillim për politikat e brendshme të Qeverisë Shqiptare dhe realizimin e programeve dhe projekteve për forcimin e rolit të saj nëpër botë.

